



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 25

Tiranë – E hënë, 16 shtator 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 433, datë 10.9.2024	Për ndërprerjen e funksionit të anëtarit të Komisionit Disiplinor të Përmbauesve Gjyqësor Privat, të z. Erind Mërkuri.....	3
Njoftim i Ministrisë së Drejtësisë nr. 4659, datë 12.9.2024	Për shprehje interesi për kandidatët që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme.....	3
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 22/4, datë 16.9.2024	Për ofertë për furnizimin dhe instalimin e pajisjeve, rrjetet lokale për spitalet.....	4



URDHËR

Nr. 433, datë 10.9.2024

**PËR NDËRPRERJEN E FUNKSIONIT
TË ANËTARIT TË KOMISIONIT
DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE
GJYQËSORË PRIVATË, TË Z. ERIND
MËRKURI**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të shkronjës “b”, të pikës 1, dhe të pikave 2, 7 dhe 9, të nenit 73 të ligjit nr. 26/2019, “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”; si dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 197, datë 26.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtar të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësor Privat”,

KONSTATOJ:

Me urdhrin nr. 399, datë 26.11.2020, “Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”, z. Erind Mërkuri është zgjedhur anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë. Mandati si anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë i ka filluar më datë 1.12.2020, me afat përfundimi më datë 30.11.2024.

Me shkresën e protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. E-348 prot., datë 23.7.2024, z. Erind Mërkuri ka njoftuar dorëheqjen, me arsyetimin se, meqenëse si përfaqësues i shoqërisë civile, nga hedhja e shortit është vendosur që emri i tij t’i propozohet seancës plenare të Kuvendit, për t’u zgjedhur si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Referuar vendimit nr. 69/2024, “Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 129, datë 26.7.2024, z. Erind Mërkuri është zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të shkronjës “b”, të pikës 1, dhe të pikave 2, 7 dhe 9, të nenit 73, të ligjit nr. 26/2019, “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”; si dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 197, datë 26.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtar të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”,

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e funksionit, si anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, të z. Erind Mërkuri.

2. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave dhe njoftimin e këtij urdhri z. Erind Mërkuri, Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, si dhe Shkollës së Magjistraturës.

3. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË

Ulsi Manja

NJOFTIM

Nr. 4659, datë 12.9.2024

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR
KANDIDATËT QË KËRKOJNË TË
CERTIFIKOHEN SI NDËRMJETËS TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në ligjin nr. 9/2022, “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”, dhe në urdhrin nr. 187, datë 4.5.2022, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme mbi paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe në verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme”, janë përcaktuar rregullat për paraqitjen, trajtimin e shprehjeve të interesit, si



dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme.

Kandidati për ndërmjetës i pasurive të paluajtshme paraqet shprehjen e interesit dhe të dokumentacionin shoqërues, brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit të publikimit.

Kandidati për ndërmjetës i pasurive të paluajtshme, që kërkon të certifikohet si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme, depoziton pranë Ministrisë së Drejtësisë, përmes shërbimit postar ose dorazi, dokumentacionin bashkëngjitur:

1. Kërkesë për shprehje interesi për certifikimin si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme;
2. Kopje të mjetit të identifikimit;
3. Certifikatë familjare;
4. Kopje të njësuar të diplomës së arsimit të mesëm të lartë, të lëshuar nga një institucion arsimor i akredituar në Republikën e Shqipërisë ose diplomë të lëshuar nga një institucion arsimor i huaj, të njohur e të njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;
5. Vërtetim nga prokuroria që nuk është nën hetim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;
6. Vërtetim nga gjykata që nuk është nën gjykim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;
7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore të kandidatit dhe për personat e lidhur me të;
8. Vetëdeklarim që nuk ka dënim me masë administrative gjobë ose masë administrative, që detyron subjektin të ndalë një sjellje të caktuar, praktikë pune apo biznesi, si dhe të mos e përsëritë në të ardhmen, për shkelje të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, të paktën jo më herët se 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;
9. Certifikatë për përfundimin me sukses të programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme;
10. Dokument që provon zotërimin e gjuhës shqipe, të lëshuar nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi (për shtetasin e huaj).

KËRKESË

Nr. 22/4, datë 16.9.2024

PËR OFERTË PËR FURNIZIMIN DHE INSTALIMIN E PAJISJEVE, RRJETET LOKALE PËR SPITALET

Datë 16 shtator 2024

Kërkesa për oferta (Procesi i ofertimit me një zarf)

Shteti: Shqipëria

Emri i projektit: Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor (Financim Shtesë)

Titulli i kontratës: Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve, rrjetet lokale për spitalet

Nr. i huas: IBRD-93060

1. Qeveria e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore për koston e Projektit të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor (Financim shtesë) dhe synon të aplikojë një pjesë të të ardhurave për pagesat, sipas kontratës për furnizimin dhe instalimin e pajisjeve, rrjetet lokale për spitalet IFB nr. AL-MH-330917-GO-RFB

2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tani fton ofertat e vulosura nga ofertuesit e kualifikuar për pajisje mjekësore për spitalet: Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve, rrjetet lokale për spitalet nr. IFB: AL-MH-330917-GO-RFB

3. Kontrata pritët të përfundojë brenda maksimumit prej 4 muajsh kalendarikë. Procesi i tenderimit është i hapur për të gjithë ofertuesit që plotësojnë kriteret e mëposhtme të kualifikimit (më shumë informacion specifik mund të gjeni në dokumentet e tenderit për këtë procedurë).

a) **Aftësia financiare:** Ofertuesi duhet të dorëzojë pasqyrat financiare të audituara ose, nëse nuk kërkohet nga ligji i vendit të ofertuesit, pasqyra të tjera financiare të pranueshme për blerësin, për tre (tre) vjetët e fundit para afatit të dorëzimit të ofertave, duke demonstruar qëndrueshmërinë aktuale të pozicionit financiar të ofertuesit. Për një sipërmarrje të përbashkët, kjo kërkesë duhet të plotësohet nga çdo anëtar:

- Ofertuesi duhet të demonstrojë disponueshmërinë e aseteve likuide prej së paku 265,000 eurosh në datën e lëshimit të kësaj dokumenteve të tenderit.



- Ofertuesi duhet të demonstrojë qarkullim mesatar vjetor prej së paku 2,100,000 eurosh në 3 (tre) vjetët e fundit kalendarikë (2021, 2022 dhe 2023).

b) **Përvojë specifike:** Ofertuesi duhet të demonstrojë se ka përfunduar me sukses të paktën 2 (dy) kontrata brenda 5 vjetët të fundit, duke përmbushur kriteret e mëposhtme:

- Gjatë 5 (pesë) vjetët të fundit, ofertuesi (2019–2023) duhet të ketë përfunduar së paku 2 (dy) kontrata të suksesshme me një vlerë prej së paku 850,000 euro secila, duke përfshirë në secilën nga kontratat të gjitha aktivitetet e mëposhtme: furnizim, zhvillim, instalimi dhe mbështetja pas shitjes për infrastrukturën e nivelit të ndërmarrjes, duke përfshirë serverat, ruajtjen, rrjetin dhe shërbimet e infrastrukturës përkatëse. Këto sisteme referimi duhet të jenë plotësisht funksionale në datën e lëshimit të këtyre dokumenteve të tenderit. Në rastin e një JV-je, drejtuesi duhet të ketë përfunduar të paktën një nga ato kontrata

Për një sipërmarrje të përbashkët, kjo kërkesë mund të plotësohet nga të gjithë anëtarët së bashku:

- Ofertuesi (një firmë individuale ose sipërmarrje e përbashkët - JV) duhet të ketë qenë në operim në të gjitha fushat e mëposhtme: softuerin e aplikacionit të bazës së të dhënave, sistemin e informacionit të menaxhimit, gjithashtu projektimin, instalimin, garancinë dhe mbështetjen e sistemit të prodhimit (përbërësit e sistemit) në përputhje me këtë kontratë për një periudhë minimale pesë (5) vjet (2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023). Drejtuesi i JV-së duhet të ishte aktiv në secilën prej këtyre fushave.

c) **Dëshmi të dokumentuara:** Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi të dokumentuara për të vërtetuar se mallrat ofertat plotësojnë kërkesat e mëposhtme të përdorimit:

- Ofertuesi do të sigurojë autorizimin e prodhuesit për të gjitha pajisjet harduerike duke deklaruar minimalisht se ofertuesi është i autorizuar të rishesë, ofrojë shërbime dhe mbështetje për pajisjet brenda territorit shqiptar.

- Shitësit duhet të kenë të paktën një certifikatë nga lista e mëposhtme: seritë ISO 9000, ISO 9001: 2015 ose ekuivalente për menaxhimin e cilësisë dhe ISO 27001:2013 ose ekuivalente për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe ISO 20000-1: 2011 – Teknologjia e informacionit – Menaxhimi i shërbimit (ofertuesi duhet të dorëzojë kopje të

noterizuara të certifikatës për pajtueshmërinë e lëshuar nga organi i autorizuar).

d) Kërkesat e stafit

Ofertuesi duhet të demonstrojë kompetenca teknike me të paktën 10 (dhjetë) punonjës/konsulentë të IT-së të certifikuar në fushat e mëposhtme, të kombinuara për të përmbushur kërkesat e mëposhtme:

(Një anëtar/konsulent i stafit mund të mbulojë më shumë se një (1) rol nga lista e mëposhtme, por jo më shumë se 2 pozicione si ekspert kryesor/kryesor):

a) Të paktën 1 (një) menaxher projekti me të paktën 3 vjet përvojë të dëshmuar në fushën përkatëse, që ka një certifikatë të vlefshme në menaxhimin e projektit si PMP (Profesionist i Menaxhimit të Projektit) ose ekuivalent. Menaxheri i Projektit do të jetë i disponueshëm në Shqipëri gjatë gjithë afatit kohor të projektit.

b) Së paku 1 (një) specialist i certifikuar në kuadër të ITIL-së. Specialistët duhet të kenë të paktën 2 vjet përvojë në veprimtarinë e menaxhimit të shërbimeve të IT-së.

c) Së paku 1 (një) specialist i certifikuar si analist i sigurisë. Specialisti duhet të ketë një eksperiencë minimale 2-vjeçare, me angazhim përkatës në projekte IT-je.

d) Së paku 2 (dy) specialistë të certifikuar për *Routing* dhe *Switching*, nivel minimal profesional. Specialisti duhet të ketë minimumi 2 vjet përvojë, me angazhim përkatës në projekte IT-je.

e) Të paktën 1 (një) specialist i certifikuar për nivelin minimal profesional të sigurisë së rrjetit. Specialisti duhet të ketë një eksperiencë minimale 2-vjeçare me angazhim në projekte IT-je.

f) Të paktën një (1) specialist i certifikuar për virtualizimin e rrjetit të propozuar, nivel minimal profesional. Specialisti duhet të ketë të paktën 2 vjet përvojë, me angazhim përkatës në projektin IT për të mbështetur konfigurimet e nevojshme në qendrën e të dhënave përkatëse për faqet e spitaleve të reja që do të shtohen.

Informacion më të detajuar dhe dispozitë më specifike mbi kriteret e kualifikimit të përmbushjes dhe dokumentet përkatëse që do të dorëzohen mund të gjenden në dokumentet e tenderit.

Ofertimi do të kryhet nëpërmjet prokurimit konkurrues ndërkombëtar duke përdorur një kërkesë për oferta (RFB), siç specifikohet në



“Rregulloret e prokurimit për huamarrësit IPF” të Bankës Botërore, korrik 2016, i Bankës Botërore, rishikuar në nëntor 2017 dhe në gusht 2018 (Rregulloret e prokurimit) dhe është e hapur për të gjithë ofertuesit, siç përcaktohet në Rregulloren e prokurimit.

Ofertuesit e interesuar të kualifikuar mund të marrin informacione të mëtejshme në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës nga ora 08:00 deri në 16:30 (e hënë në të enjte) dhe nga ora 08:00 deri në 14:00 të premten:

Dokumenti i tenderit në gjuhën angleze mund të blihet nga ofertuesit e interesuar të kualifikuar me paraqitjen e një aplikimi me shkrim në adresën e mëposhtme dhe me pagesën e një tarife të pakthyeshme prej 20,000 lekësh shqiptare. Mënyra e pagesës do të jetë me transfertë bankare. Dokumenti do të dërgohet me *e-mail*. Ofertuesit e interesuar janë të lutur t'i dërgojnë Njësisë së Koordinimit të Projektit (PCU) një *e-mail* ose letër për të regjistruar interesin e tyre për të marrë pjesë në këtë procedurë tenderimi së bashku me vërtetimin e pagesës. Një grup i plotë i dokumenteve të tenderit do të dërgohet pas marrjes së aplikacionit me shkrim ose me *e-mail* së bashku me transaksionin bankar.

Kërkesa për dokumentet e tenderit duhet të dorëzohet në adresën e mëposhtme:

Në vëmendje: Znj. Blerina Dudushi – Menaxhere e Projektit të PCU-së

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shqipëri

Adresa: Rruga e Kavajës, Qyteti: Tiranë, Kodi Postar: 1000

Shteti: Shqipëri

Adresa e postës elektronike: hsip.dudushi@gmail.com

Detajet bankare për pagesën e shumës 20,000 lekë shqiptare:

Emri i Projektit:	PROJEKTI PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT SHËNDETËSOR – HSIP
Emri i bankës:	CREDINS BANK
Numri i llogarisë (lek shqiptar)	00000739082
IBAN: (lek shqip.)	AL89 2121 1528 0000 0000 0073 9082
SWIFT:	CDISALTRXXX

Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme më ose përpara datës 16 tetor 2024. Ofertimi elektronik nuk do të lejohet. Ofertat e vonuara do të refuzohen. Ofertat do të hapen

publikisht në prani të përfaqësuesve të caktuar të ofertuesve dhe kujtdo që do të zgjedhë të marrë pjesë në adresën e mëposhtme **më 16 tetor 2024 me orën lokale 11:15.**

Vetëm për qëllime të dorëzimit të ofertave, adresa e punëdhënësit është:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Rruga e Kavajës – Tiranë, Shqipëri

Qyteti: Tiranë

Kodi ZIP: 1000

Shteti: Shqipëri

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është:

Datë 16 tetor 2024

Ora: 11:00

Hapja do të bëhet:

Datë 16 tetor 2024

Ora: 11:15

4. Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen me një garanci të ofertës në vlerë prej 21,000 eurosh. Sigurimi i ofertës do të jetë i vlefshëm për 28 (njëzet e tetë) ditë përtej datës origjinale të skadimit të vlefshmërisë së ofertës, ose përtej çdo date të zgjatur nëse kërkohej sipas ITB 18.2.

5. Vëmendje për rregulloret e prokurimit që kërkojnë që huamarrësi të japë informacion mbi pronësinë përfituese të ofertuesit të suksesshëm, si pjesë e njoftimit për dhënien e kontratës, duke përdorur formularin e zbulimit të pronësisë përfituese, siç përfshihet në dokumentin e tenderit.

6. Adresat e përmendura më sipër janë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në vëmendje të: Znj. Entela Ramosaçaj (zëvendësministre)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Rruga e Kavajës – Tiranë, Shqipëri

Qyteti: Tiranë

Kodi ZIP: 1000

Shteti: Shqipëri



Specific Procurement Notice

Dated 16 September 2024

Request for Bids
(One-Envelope Bidding Process)**Country:** Albania**Name of Project:** Health System Improvement Project (Additional Financing)**Contract Title:** Supply and Installation of Equipment, local networks for Hospitals**Loan No:** IBRD-93060

1. The *Government of Albania* has received a financing from the World Bank toward the cost of the health System Improvement project (Additional Financing), and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for ***Supply and Installation of Equipment, local networks for Hospitals IFB No: AL-MH-330917-GO-RFB***

2. The *Ministry of Health and Social Protection* now invites sealed Bids from eligible Bidders for Medical Equipment for Hospitals: ***Supply and Installation of Equipment, local networks for Hospitals IFB No: AL-MH-330917-GO-RFB***

3. The contract is expected to be completed within maximum 4 calendar months. The bidding process is opened to all the Bidders that fulfill the following qualification criteria: (more specific information may be found in the Bidding documents for this procedure).

a) **Financial Capability:** The Bidder shall submit audited financial statements or, if not required by the law of the Bidder's country, other financial statements acceptable to the Purchaser, for the last three (three) years prior to bid submission deadline, demonstrating the current soundness of the Bidder's financial position. For a joint venture, this requirement shall be met by each member:

- Bidder shall demonstrate availability of liquid assets of at least 265,000 euro at the date of issuing these bidding documents.

- Bidder shall demonstrate average annual turnover of at least 2,100,000 Euro in last three (3) calendar years (2021, 2022, and 2023).

b) **Specific Experience:** The Bidder shall demonstrate that it has successfully completed at

least 2 (two) contracts within the last 5 years meeting the following criteria:

- During the past five (5) years the Bidder (2019-2023) must have completed at least two (2) successful contracts with a value of at least 850,000 euro each, involving in each of the contracts all the following activities: supply, development, installation, and post-sales support for enterprise-level infrastructures including servers, storage, network, and related infrastructure services. Those reference systems should be fully operational at the date of issuing these bidding documents. In case of a JV, the leader should have completed at least one of those contracts

For a joint venture, this requirement may be met by all members combined.

- Bidder (an individual firm or joint venture - JV) must have been in operation in all the following fields: database application software, management information system, also design, installation, warranty, and support of production system (system components) in accordance with this Contract for a period of minimum five (5) years (2019, 2020, 2021, 2022, and 2023). The leader of the JV should have been active in each of those fields.

c) **Documentary Evidence:** The Bidder shall furnish documentary evidence to demonstrate that the goods it offers meet the following usage requirement:

- The Bidder shall provide Manufacturer Authorization for all hardware equipment stating as a minimum that the Bidder is authorized to resell, provide services and support for the equipment within Albanian Territory.

- Vendors shall have at least on certificate out of the following list: ISO 9000 series, ISO 9001: 2015 or equivalent for quality management and ISO 27001:2013 or equivalent for managing information security and ISO 20000-1: 2011 – Information Technology – Service management (Bidder shall submit notarized copies of Certificate on compliance issued by the authorized body).

d) **Staff requirements**

Bidder must demonstrate technical competencies with at least 10 (ten) IT staff members/consultant certified in the following fields, combined to fulfill the following requirements:



(One staff member/consultant could cover more than one (1) role from the following list, but no more than 2 positions as a Primary/Key Expert):

a) At least one (1) Project Manager with at least 3 years of proven experience in the relevant field, holding a valid certification in Project management such as PMP (Project Management Professional) or equivalent. The Project Manager shall be available in Albania during the whole project timeline.

b) At least one (1) Specialist certified in ITIL framework. The specialists should have a minimum of 2 years of experience in IT service management activity.

c) At least one (1) specialist certified as security analyst. The specialist should have a minimum of 2 years of experience, with relevant engagement in IT Projects.

d) At least two (2) specialists certified for Routing and Switching minimum professional level. The specialist should have a minimum of 2 years of experience, with relevant engagement in IT projects.

e) At least one (1) specialist certified for Network security minimum professional level. The specialist should have a minimum of 2 years of experience with engagement in IT projects.

f) At least one (1) specialist certified for the proposed network virtualization, minimum professional level. The specialist should have a minimum of 2 years of experience, with relevant engagement in IT Project to support necessary configurations in the datacenter relevant to the new hospitals sites that will be added.

More detailed information and more specific provision on the fulfillment qualification criteria and the relevant documents to be submitted may be found in the Bidding Documents.

Bidding will be conducted through international competitive procurement using a Request for Bids (RFB) as specified in the World Bank's "Procurement Regulations for IPF Borrowers" (World Bank's July 2016 Revised November 2017 and August 2018) (Procurement Regulations") and is open to all Bidders as defined in the Procurement Regulations.

Interested eligible Bidders may obtain further information from Interested eligible Bidders may obtain further information from can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday:

The bidding document in English may be purchased by interested eligible Bidders upon the submission of a written application to the address below and upon payment of a nonrefundable fee of 20,000 Albanian Lekë. The method of payment will be through bank transfer. The document will be sent by e-mail. Interested Bidders are requested to send to the project coordination Unit (PCU) an email or letter to register their interest to participate in this bidding procedure along with the proof of payment. A complete set of the bidding documents will be sent upon receipt of that written or email application along with the bank transaction.

The request for Bidding documents must be submitted in the following address:

In attention to: Mrs. Blerina Dudushi – PCU Project Manager

Ministry of Health and Social Protection, Albania

Address: Rruga e Kavajës, City: Tirana, ZIP Code: 1000

Country: Albania

Electronic mail address: hsip.dudushi@gmail.com

Bank Details for payment of the amount of 20,000 Albanian Lekë:

Project Name:	PROJEKTI PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT SHËNDETSOR – HSIP
Bank Name:	CREDINS BANK
Account Number (Albanian Lekë)	00000739082
IBAN: (Albanian Lekë)	AL89 2121 1528 0000 0000 0073 9082
Swift:	CDISALTRXXX

Bids must be delivered to the address below on or before date **16th of October 2024**. Electronic Bidding will *not* be permitted. Late Bids will be rejected. Bids will be publicly opened in the presence of the Bidders' designated representatives and anyone who chooses to attend at the address below **on 16th of October 2024, local time 11:15.**

For **Bid submission purposes** only, the Employer's address is:

Ministry of Health and Social Protection

Ministry of Health and Social protection, **Rruga e Kavajës – Tirana Albania**

City: **Tirana**

ZIP Code: **1000**

Country: **Albania**



The deadline for Bid submission is:

Date 16th of October 2024

Time: 11:00 AM

The opening shall take place:

Date 16th of October 2024

Time: 11:15 AM

4. All Bids must be accompanied by a Bid Security in a value of 21,000 Euro. The Bid Security shall be valid for twenty-eight (28) days beyond the original date of expiry of the Bid validity, or beyond any extended date if requested under ITB 18.2

5. Attention is drawn to the Procurement Regulations requiring the Borrower to disclose information on the successful bidder's beneficial ownership, as part of the Contract Award Notice, using the Beneficial Ownership Disclosure Form as included in the bidding document.

6. The address(es) referred to above is (are):

Ministry of Health and Social Protection

In attention to. Mrs. Entela RAMOSAÇAJ

(Deputy minister)

**Ministry of Health and Social protection, Rruga
e Kavajës- Tirana Albania**

City: **Tirana**

ZIP Code: **1000**

Country: **Albania**

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2024

